01140	e-Qeverisja	6,248,541	3,247,000	470,000	3,717,000	9,965,541
01330	Menaxhimi dhe zhvillimi i administratës publike	464,720	23,000	88,100	111,100	575,820
08610	Mbështetje për rininë dhe fëmijët	118,829	50,000	0	50,000	168,829
08480	Mbështetje për kultet fetare	142,329	1,000	0	1,000	143,329
88	Mbështetje për Shoqërinë Civile	131,259	1,000	0	1,000	132,259
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	131,259	1,000	0	1,000	132,259
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	140,428	1,000	0	1,000	141,428
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	140,428	1,000	0	1,000	141,428
90	Komisioni i Prokurimit Publik	113,767	1,000	0	1,000	114,767
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	113,767	1,000	0	1,000	114,767
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	72,992	1,000	0	1,000	73,992
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	72,992	1,000	0	1,000	73,992
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	56,440	1,000	0	1,000	57,440
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	56,440	1,000	0	1,000	57,440
95	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	156,037	2,000	0	2,000	158,037
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	156,037	2,000	0	2,000	158,037
TOTALI		313,133,796	87,655,000	43,412,000	131,067,000	444,200,796



Tab. 2

Kod min.	Emërtimi i ministrisë/institucionit buxhetor	Numri i punonjësve AN 2024
1	Presidenca	93
2	Kuvendi	465
3	Kryeministria	215
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	2,560
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1,216
10	Ministria e Financave	3,238
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	31,000
12	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	4,002
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	4,334
14	Ministria e Drejtësisë	5,346
15	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	561
16	Ministria e Brendshme	15,296
17	Ministria e Mbrojtjes	8,863
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	998
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	139
22	Akademia e Shkencës	29
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	243
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	894
28	Prokuroria e Përgjithshme	962
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	1,759
30	Gjykata Kushtetuese	68
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	40
35	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	72
41	SPAK/BKH	271
50	Instituti i Statistikës	236
55	Shkolla e Magistraturës	41
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9
63	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	76
63	Kolegji i Posaçëm i Apelit	63
63	Komisioneri Publik	30
63	Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	101
66	Avokati i Popullit	66
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	37
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	95
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	73
77	Autoriteti i Konkurrencës	49
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	Institucione të tjera Qeveritare	1,553
1	Drejtoria Sigurimit të Informacionit Klasifikuar (DSIK)	38
2	Agjencia e Prokurimit Publik	48
3	Komiteti për Paketat Kombëtare	24
4	Inspektorati Qendror	21
5	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore	82
6	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje	70
7	Agjencia e Zhvillimit të Territorit	43
8	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	41
9	Agjencia Autonome e Auditimit të Fondave të BE	23
10	Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit	398
11	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike (ADIS-A)	164
12	Komiteti Shtetëror i Kulturës	10
13	Departamenti i Administratës Publike	61
14	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	22
15	Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion	27
15	Autoriteti Komb. Cert. Elektrikë (ACESK)	85
16	Sekretariati Teknik i KEK	6
17	Autoriteti Shtetëror Gjeobazsinor (ASIG)	73
18	Avokatura e Shtetit	107
19	Agjencia Kombëtare e Rinsë	30
20	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës	69
21	Agjencinë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve	10
22	Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vëndore	32
25	Agjencia për Media dhe Informim	69
88	Mbështetje për shoqëri civile	16
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	60
90	Komisioni i Prokurimit Publik	42
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	34
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	22
95	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	73
Total punonjës buxhetore		85,346
Rezervë për institucione të qeverisjes qendrore		100
Total numri i punonjësve		85,446



TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR PËR BASHKITË PËR VITIN 2024

Tab. 3

Në mijë lekë

Nr.	Bashkitë	Transferata e pakushtëzuara e përgjithshme: 2024	Transferatet e pakushtëzuara sektoriale															Totali
			Konsvikat e asistimit parauniversitar	Asistimi parashkolëz		Asistimi parauniversitar	Mbrojtja nga zjarri	Mbrojtja sociale	Administrimi i prapjeve	Rrugët	Ujitja dhe Kullimi	Klubit shportiv të "Partizanit" dhe "Studentit"	Rritja e nivelit të pagave	Menaxhimi i mbetjeve urbane	Menaxhimi i mbetjeve urbane (shituar nga Kuvendi)	Shërbime me AN "Financimi i një projekti pilot zhvillimi"		
				Ndihmë me formale për personelin mësues	Për stafin mësues													
1	Bekësi	163,764	0	30,920	1,681	1,506	15,647	0	1,063	9,716	11,159	0	11,309	3,061			249,816	
2	Berat	418,077	29,350	122,272	49,011	16,816	36,740	25,445	6,751	3,587	16,793	0	28,702				755,913	
3	Bilakësi	330,683	0	61,954	12,175	0	21,996	16,540	35,454	14,986		0	16,182				529,980	
4	Cërre	199,627	4,927	52,285	6,661	6,787	17,432	0	2,580	2,731	17,963	0	13,998	6,632			331,122	
5	Dhërri	86,048	0	23,534	6,135	2,195	15,783	0	3,016	4,185	11,159	0	11,645				164,592	
6	Dhërri	257,125	0	62,897	4,210	3,041	16,032	0	5,413	12,889	12,965	0	14,922				389,495	
7	Dhërri	550,281	25,807	143,809	36,145	11,497	29,303	0	9,807	17,378	15,800	0	31,559				871,475	
8	Dhërri	282,939	0	62,422	1,838	1,582	15,037	0	1,057	9,624	34,001	0	19,575		15,000	128,000	570,876	
9	Dhërri	106,820	0	31,139	534	1,401	15,647	0	5,357	6,230	7,025	0	10,973				171,818	
10	Dhërri	1,211,509	24,376	221,249	61,875	23,078	58,109	0	3,819	29,705	51,252	0	43,010				1,969,654	
11	Dhërri	991,175	30,300	257,699	71,066	40,381	40,220	22,632	14,477	21,622	16,793	0	30,800	18,263			1,544,028	
12	Fier	837,900	22,809	196,399	50,848	13,439	39,455	0	4,810	10,542	66,917	0	51,976		20,000		1,342,686	
13	Fier	160,443	0	10,199	1,667	0	24,348	0	4,307	3,475	17,696	0	11,561				233,693	
14	Fushë-Arrëz	103,802	0	26,575	12,253	5,686	23,070	0	22,250	16,616	3,197	0	11,561				225,029	
15	Gjakovë	285,728	19,574	92,534	30,632	7,396	34,468	0	8,407	9,481	10,852	0	16,182				541,475	
16	Gjakovë	286,762	6,021	80,415	11,027	4,528	19,756	0	17,967	24,078	11,159	0	18,031				484,767	
17	Has	191,982	7,214	39,640	4,210	3,614	17,600	0	17,840	1,972	12,714	0	13,157				309,943	
18	Has	159,741	0	17,044	1,147	757	18,268	0	9,417	5,521	11,159	0	12,757				261,298	
19	Kamë	714,246	0	232,810	36,468	12,334	52,696	0	584	0	4,100	0	52,985				1,144,270	
20	Kamë	303,680	13,639	81,999	20,830	7,966	19,914	0	1,057	6,932	22,426	0	20,458				566,059	
21	Kamë	351,088	0	9,440	1,838	3,515	15,826	0	3,701	9,481	11,159	0	10,973				166,459	
22	Kamë	185,316	0	30,478	6,739	6,739	9,949	0	8,049	12,446	3,197	0	12,821				278,003	
23	Kamë	160,068	10,419	37,401	6,739	5,027	18,535	0	18,131	11,040	19,947	0	10,889				288,095	
24	Korçë	82,462	0	12,565	1,681	0	15,647	0	2,052	2,137	12,062	0	7,528				136,135	
25	Korçë	998,629	23,461	165,468	53,299	23,132	35,124	0	18,075	8,094	51,897	0	20,978				1,007,057	
26	Korçë	396,148	20,138	95,838	4,444	4,444	21,762	0	7,092	8,795	18,599	0	17,191				631,329	
27	Korçë	226,489	0	69,984	22,667	8,372	17,023	0	1,772	2,400	14,986	0	16,938				382,534	
28	Korçë	428,363	20,840	104,071	38,596	6,022	62,099	2,678	13,535	23,764	7,025	0	23,240				730,833	
29	Korçë	315,779	0	95,956	27,691	18,574	18,416	0	3,428	4,787	23,330	0	16,770				535,444	
30	Korçë	499,562	9,971	114,248	33,695	20,338	43,195	0	9,435	6,402	20,099	0	20,236				760,556	
31	Korçë	548,571	0	6,009	1,681	1,412	15,647	0	3,306	7,855	5,091	0	5,408				105,313	
32	Korçë	568,755	0	78,858	12,175	3,841	16,632	0	10,494	29,792	14,986	0	20,047				559,274	
33	Korçë	566,804	9,917	159,266	37,965	13,944	17,448	0	2,059	9,066	53,703	0	35,004				925,205	
34	Korçë	391,293	4,512	166,339	3,675	4,474	31,408	0	10,028	15,972	14,986	0	20,809				584,477	
35	Korçë	401,661	0	92,212	4,741	12,521	15,647	0	6,879	10,729	45,540	0	22,820				609,574	
36	Korçë	210,177	0	67,213	18,992	8,109	17,385	0	3,468	8,860	14,986	0	13,830				373,079	
37	Korçë	250,009	13,514	63,714	22,667	8,818	18,893	0	10,686	31,100	13,233	0	20,888				453,521	
38	Korçë	130,867	0	36,963	6,135	9,196	15,854	0	3,912	5,418	3,306	0	9,796				240,702	
39	Korçë	265,539	23,463	55,109	20,621	9,316	24,401	0	18,009	23,163	17,000	0	19,207				475,951	
40	Korçë	171,935	0	48,782	15,516	4,381	21,096	0	1,167	2,232	10,631	0	20,636				307,085	
41	Korçë	180,660	0	44,672	6,048	4,631	16,345	0	1,747	5,325	11,159	0	18,055				301,784	
42	Korçë	156,410	7,038	25,262	6,135	5,735	19,316	0	6,921	8,397	11,159	0	14,334				278,596	
43	Korçë	483,138	0	153,598	9,111	11,703	21,627	0	19,330	25,199	12,062	0	35,172				770,940	
44	Korçë	130,813	0	30,892	8,254	6,130	17,242	0	4,676	4,220	4,055	0	8,956				215,218	
45	Korçë	232,055	0	49,793	5,070	4,348	18,208	0	8,950	22,704	13,233	0	15,342				377,540	
46	Korçë	147,321	14,663	35,438	15,516	9,014	21,471	0	14,749	7,954	3,197	0	10,889				282,767	
47	Korçë	46,518	0	6,869	331	0	20,366	0	1,059	383	6,348	0	7,276				89,089	
48	Korçë	180,096	0	34,597	2,985	2,879	15,647	0	1,167	4,875	7,928	0	13,546				235,921	
49	Korçë	195,957	0	36,474	7,273	2,920	15,037	0	1,722	0	11,159	0	12,149				299,323	
50	Korçë	180,074	19,698	51,511	15,028	4,364	21,237	0	3,079	0	7,025	0	16,350				362,731	
51	Korçë	228,819	0	31,564	5,436	11,404	17,717	0	5,479	3,384	17,475	0	11,813				333,090	
52	Korçë	198,877	0	43,206	7,965	3,686	20,210	0	1,057	39	7,025	0	12,401				313,206	
53	Korçë	189,786	62,068	189,954	64,940	30,629	46,597	38,183	13,543	23,061	19,980	0	43,238				1,413,315	
54	Korçë	113,289	11,880	40,491	13,800	10,074	21,515	0	10,236	15,567	16,543	0	12,889				377,085	
55	Korçë	114,721	7,214	37,788	9,802	4,354	16,213	0	6,128	9,385	3,306	0	10,005				234,139	
56	Korçë	3,435,480	96,393	680,062	317,344	108,334	134,539	0	11,795	24,361	23,851	32,630	297,150				5,179,858	
57	Korçë	272,814	0	49,242	14,090	4,404	19,338	0	17,536	10,731	3,717	0	14,250				406,141	
58	Korçë	182,931	0	54,053	534	1,919	15,783	0	1,059	4,638	20,027	0	14,418				296,242	
59	Korçë	229,147	9,350	65,721	1,667	2,869	15,037	20,363	7,946	13,868	0	0	21,224				445,275	
60	Korçë	761,086	27,628	253,137	8,254	30,566	48,566	0	7,022	4,546	44,868	0	37,440				1,284,312	
61	Korçë	173,293	0	49,628	2,985	6,068	15,037	0	1,054	601	11,159	0	22,148				306,562	
Totali		22,066,781	556,946	5,130,902	1,372,957	609,662	1,546,805	139,700	468,559	646,628	1,037,307	32,650	1,489,908	74,000	128,000		35,954,917	



TREGUESIT FISKALE TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2021–2026
FISCAL INDICATORS REGARDING CONSOLIDATED BUDGET OF 2021–2026

Nr.	EMËRTIMI	Akti Normativ 2024	Në % të PBB-së	Buxheti 2025	Në % të PBB-së	Buxheti 2026	Në % të PBB-së	ITEMS
I.	TOTALI TË ARDHURAVE	686,798	28.2%	714,674	27.9%	753,875	28.0%	TOTAL REVENUE
	Të ardhura nga ndihmat	16,957	0.7%	16,365	0.6%	16,200	0.6%	Grants
	<i>Nga të cilat: mbishitje investive</i>	1,957	0.1%	865	0.0%	900	0.0%	<i>from which: Budget Support</i>
	<i>Nga të cilat: projekte të destinuara për investime</i>	15,000	0.6%	15,500	0.6%	15,300	0.6%	
II.	Të ardhura tatimore	636,540	26.1%	674,160	26.4%	713,075	26.5%	Tax Revenue
II.1	Nga tatimet dhe doganat	449,802	18.5%	477,642	18.7%	504,426	18.7%	From tax offices and customs
	Tatimi mbi vlerën e shtuar	211,703	8.7%	225,401	8.8%	238,454	8.9%	V.A.T
	Tatimi mbi fitimin	55,979	2.3%	59,193	2.3%	62,444	2.3%	Profit Tax
	Akcizat	63,602	2.6%	67,615	2.6%	71,260	2.6%	Excise Tax
	Tatimi mbi të ardhurat personale	65,206	2.7%	69,320	2.7%	73,196	2.7%	Personal Income Tax
	Taksa racionale dhe të tjera	44,292	1.8%	46,635	1.8%	49,102	1.8%	National Taxes and others
	Taksa Doganore	9,021	0.4%	9,478	0.4%	9,970	0.4%	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga pushteti vendor	29,114	1.2%	30,517	1.2%	33,531	1.2%	Local Taxes
	Taksa lokale	23,403	1.0%	24,589	1.0%	25,866	1.0%	Local Taxes
	Tatimi mbi pasurinë (ndërtuesat)	5,711	0.2%	5,928	0.2%	7,665	0.3%	Property Tax
II.3	Të ardhurat nga fondet speciale	157,625	6.5%	166,000	6.5%	175,118	6.5%	Revenues from Special Funds
	Sigurimi Shqiptar	136,239	5.6%	143,555	5.6%	151,438	5.6%	Social Insurance
	Sigurimi Shëndetësor	20,481	0.8%	21,540	0.8%	22,680	0.8%	Health Insurance
	Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	905	0.0%	905	0.0%	1,000	0.0%	Revenues for owners' in value-compensation
III.	Të ardhura joutimore	33,301	1.4%	24,150	0.9%	24,600	0.9%	Nontax Revenue
	Transferata e fitimit nga Banka e Shqipërisë	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%	Profit transfer from BoA
	Të ardhura nga institucionet buxhetore	13,300	0.5%	13,200	0.5%	13,600	0.5%	Income from budgetary institutions
	Dividenti	300	0.0%	300	0.0%	300	0.0%	Dividend
	Tarifat e shërbimeve	3,700	0.2%	3,800	0.1%	3,900	0.1%	Services Fees
	Të tjera	8,101	0.3%	6,850	0.3%	6,800	0.3%	Others
	Rezultati financiar i ISSH-së	7,900	0.3%					
I.	TOTALI I SHPENZIMEVE	744,079	30.6%	766,610	30.0%	806,005	30.0%	TOTAL EXPENDITURE
1	Shpenzime Korrente	605,998	24.9%	633,235	24.8%	670,938	24.9%	Current Expenditures
	Personeli	119,999	4.9%	124,941	4.9%	133,760	5.0%	Personnel expenditures
	Paga	92,432	3.8%	104,707	4.1%	105,357	3.9%	Wages
	Kontributi për Sigurime Shqiptare	15,167	0.6%	18,834	0.7%	19,034	0.7%	Social insurance contributions
	Fondi i vëçantë i pagave	400	0.0%	400	0.0%	400	0.0%	Bonus fund
	Politika të reja pagash	11,000	0.5%		0.0%	3,000	0.1%	Contingency for new wage policies
	Indeksimi i pagave					4,970	0.2%	Wage indexation
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	1,000	0.0%	1,000	0.0%	1,000	0.0%	Higher Education from its own revenues
2	Interesat	66,158	2.7%	72,102	2.8%	80,978	3.0%	Interest
	Të brendshme	34,475	1.4%	39,458	1.5%	45,641	1.7%	Domestic
	Të Huaja	26,384	1.1%	27,194	1.1%	29,537	1.1%	Foreign
	Kontingjenca për risqet e bordit	5,300	0.2%	5,450	0.2%	5,800	0.2%	Contingency for debt related risks
3	Shpenzime Operative Mirëmbajtjeje nga të cilat:	67,286	2.8%	65,870	2.6%	67,721	2.5%	Operational & Maintenance of which:
	<i>Të qeverisë qendrore</i>	63,686	2.6%	62,070	2.4%	63,821	2.4%	<i>Central government</i>
	<i>Arsimi i Lartë nga të ardhurat e veta</i>	1,000	0.0%	1,000	0.0%	1,000	0.0%	<i>from revenues of Higher Education System</i>
	<i>Të tjera jashtë limitit</i>	2,600	0.1%	2,800	0.1%	2,900	0.1%	<i>from Exceptional Revenues</i>
4	Subvencionet	1,850	0.1%	1,850	0.1%	1,850	0.1%	Subsidies
5	Shpenzime për fondet speciale	248,877	10.2%	262,408	10.3%	274,843	10.2%	Social insurance outlays
	Sigurime Shqiptare	178,038	7.3%	186,593	7.3%	197,238	7.3%	Social insurance
	Politika të reja pensionesh	4,137	0.2%	4,463	0.2%	4,853	0.2%	Contingency for new pension policies
	Bonusi i pensionistëve	3,650	0.1%	3,750	0.1%	3,800	0.1%	Pensioners' Bonus
	Sigurime Shëndetësore	58,052	2.4%	62,102	2.4%	62,952	2.3%	Health insurance
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	5,000	0.2%	5,500	0.2%	6,000	0.2%	Expenditure for owners' in value-compensation
6	Shpenzime për buxhetin vendor	71,377	2.9%	75,114	2.9%	79,786	3.0%	Local Budget expenditure
	Transferatat nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor	36,785	1.5%	39,077	1.5%	40,555	1.5%	Central Government Grant for Local Government
	<i>Transferatë e pakualifikuar shkollorë e përgjithshme</i>	24,343	1.0%	25,577	1.0%	26,905	1.0%	<i>Unconditional Fund</i>
	<i>Transferatë e pakualifikuar shkollorë (grant specifike)</i>	10,942	0.4%	10,800	0.4%	10,950	0.4%	<i>Specific Grant</i>
	<i>Transferatë shkollorë për pagat</i>	1,500	0.1%	2,700	0.1%	2,700	0.1%	<i>Specific Grant for wages</i>
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)	29,114	1.2%	30,517	1.2%	33,531	1.2%	Local Budget (Own revenues)
	Taksa të ndara	1,478	0.1%	1,420	0.1%	1,500	0.1%	Local Budget (from shared taxes revenues)
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta joutimore)	3,000	0.1%	3,100	0.1%	3,200	0.1%	Local Budget (from non-tax revenues)
	Financimi i huaj vendor dhe të tjera të mbartura	1,000	0.0%	1,000	0.0%	1,000	0.0%	Local foreign financing
7	Shpenzime të tjera	30,450	1.3%	30,950	1.2%	32,000	1.2%	Other expenditures
	Pagësa e Papunësisë	800	0.0%	800	0.0%	800	0.0%	Unemployment insurance benefits
	Ndihma ekonomike dhe paafësia	26,250	1.1%	26,600	1.0%	26,900	1.0%	Social assistance and disability
	Kompensim për ish-të përndjekurit politik	1,200	0.0%	1,300	0.1%	2,000	0.1%	Compensation for ex political prisoners
	Bonusi i lindjeve	2,200	0.1%	2,250	0.1%	2,300	0.1%	Birth Bonus
II.	Fondi rezervë	2,500	0.1%	3,800	0.1%	3,000	0.1%	Reserve fund, Contingency
	Fondi rezervë	2,500	0.1%	2,000	0.1%	3,000	0.1%	Reserve Fund
III.	Shpenzime kapitale	135,581	5.6%	129,575	5.1%	132,067	4.9%	Capital expenditures
	Financimi brendshëm	87,551	3.6%	86,075	3.4%	87,655	3.3%	Domestic financing
	Investime nga të ardhurat e asimit të lartë	1,000	0.0%	1,000	0.0%	1,000	0.0%	From Higher Education System's own revenues
	Financimi huaj	40,030	1.6%	40,500	1.6%	43,412	1.6%	Foreign financing
	<i>nga të cilat: Energjia</i>	2,000	0.1%	2,000	0.1%	2,000	0.1%	<i>from which: Energy</i>
	Fondi i rindërtimit	7,000	0.3%	2,000	0.1%			Reconstruction Fund
	Transferatë kapitale për llogaritë speciale të shpronësimeve					0	0.0%	
	DEFICITI	-57,280	-2.4%	-51,936	-2.0%	-52,131	-1.9%	Cash Balance
	FINANCIMI I DEFICITIT	57,280	2.4%	51,936	2.0%	52,131	1.9%	Financing (Cash)
	Brendshëm	71,346	2.9%	62,763	2.5%	41,649	1.5%	Domestic
	Të ardhura nga privatizimi			41,000	1.6%	43,000	1.6%	Privatization receipts
	Huamarrje e brendshme	50,000	2.1%	21,763	0.9%	-1,351	-0.1%	Domestic borrowing
	Të tjera	21,346	0.9%	-10,827	-0.4%	10,482	0.4%	Other
I Huaj	Huë afatgjatë (e marrë)	-14,066	-0.6%	-10,827	-0.4%	10,482	0.4%	Foreign
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	20,030	1.1%	91,727	3.6%	83,885	3.1%	Long-term Loan(Drawings)
	Ripagesat	-52,146	-2.1%	-116,795	-4.6%	-73,403	-2.7%	Chang. of stat. Account
	Mbështetje buxhetore	12,050	0.5%	14,241	0.6%	0	0.0%	Repayments
								Budget support
	Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)	2,434,311	100.0%	2,557,741	100.0%	2,690,518	100.0%	Gross Domestic Product (GDP)

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUTSEKSIONI I TRETË
VENDIMKërkesa nr. 4586/18
ADRIAN FULLANI
KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 20 shtator 2022 si një Dhomë e përbërë nga:

Georges Ravarani, *kryetar*,
Georgios A. Serghides,
Maria Elósegui
Darian Pavli,
Anja Seibert-Fohr,
Peeter Roosma,
Andreas Zünd, *gjyqtarë*,
dhe Milan Blaško, *sekretar i Seksionit*,
duke marrë në konsideratë:

kërkesën e mësipërme depozituar pranë Gjykatës, më 12 janar 2018 kundër Republikës së Shqipërisë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga një shtetas shqiptar, z. Adrian Fullani (“kërkuesi”);

vendimin për të njoftuar qeverinë shqiptare (“Qeveria”) në lidhje me ankesën në mbështetje të nenit 8 të Konventës dhe për të deklaruar pjesën tjetër të kërkesës së papranueshme;

vërejtjet e palëve;

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET

1. Kërkuesi ka lindur në vitin 1955 dhe banon në Tiranë. Ai u përfaqësua në Gjykatë nga z. A. Saccucci, një avokat i cili e ushtron profesionin në Romë.

2. Qeveria u përfaqësua fillimisht nga ish-agjentët e saj, z. A. Metani dhe znj. E. Muçaj, dhe në vijim nga z. O. Moçka, avokat i përgjithshëm i shtetit.

3. Faktet e çështjes, të parashtruara nga palët, mund të përmbledhen si më poshtë.

A. Rrethanat që i paraprinë procedurave gjyqësore

4. Në muajin nëntor 2011, Parlamenti i Shqipërisë caktoi kërkuesin për një afat shtatëvjeçar në pozicionin e Guvernatorit të Bankës Qendrore

të Shqipërisë (“BQSH”), një institucion publik përgjegjës për zbatimin e politikës monetare në vend. Përveç pozicionit si zyrtari më i lartë i institucionit, Guvernatori kryesonte Këshillin Mbikëqyrës, që ishte organi drejtues i BQSH-së.

5. Pas arrestimit të kërkuesit më 5 shtator 2014 mbi dyshimin për shpërdorim të detyrës, më 6 shtator 2014, Këshilli Mbikëqyrës i propozoi Parlamentit shkarkimin e kërkuesit nga detyra.

6. Më 18 shtator 2014, Parlamenti vendosi të shkarkonte kërkuesin nga detyra.

B. Kundërshtimi i kërkuesit ndaj shkarkimit të tij nga detyra

7. Pas shfajësimit të tij nga akuzat penale, më 5 shkurt 2016 kërkuesi ngriti një padi kundër BQSH-së dhe Parlamentit, duke kundërshtuar shkarkimin e tij nga detyra.

8. Më 2 qershor 2016, Gjykata Administrative e Tiranës e Shkallës së Parë pranoi pjesërisht padinë e kërkuesit. Gjykata vendosi se në kundërshtim me parashtrimet e BQSH-së, nuk kishte prova se kërkuesi kishte dëmtuar interesat e BQSH-së, dhe fakti i vetëm se ai ishte arrestuar nuk përbënte një shkelje etike që të justifikonte shkarkimin e tij nga detyra. Gjithashtu, ajo konstatoi një sërë mangësish procedurale, të tilla si moslejimi i kërkuesit nga ana e autoriteteve që të merrte pjesë në procedurat e shkarkimit nga detyra. Në vijim, gjykata thekson se nuk kishte juridiksionin për të shfuqizuar vendimin e Parlamentit (shih paragrafin 6 më sipër), dhe në përputhje me rrethanat e urdhëronte BQSH-në t’i paguante kërkuesit pagën për dymbëdhjetë muaj. Gjykata e rrëzoi pretendimin e kërkuesit për kompensim shtesë për dëm jopasuror dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm, me arsyetimin se gjatë kësaj periudhe një person tjetër ishte emëruar në atë pozicion, dhe ligji nuk parashikonte mjetin e rikthimit në detyrë në ato rrethana. Të gjitha palët apelian.

9. Më 1 mars 2017, Gjykata Administrative e Apelit konfirmoi se kërkuesi ishte shkarkuar në mënyrë të paligjshme dhe ndryshoi pjesërisht vendimin e gjykatës më të ulët. Ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, ajo urdhëroi shfuqizimin e vendimit të Parlamentit të datës 18 shtator 2014 (shih paragrafin 6 më sipër). Gjithashtu, në vend të pagës së dymbëdhjetë muajve dhënë nga gjykata më e ulët, Gjykata e Apelit urdhëroi BQSH-në të paguante pagën e tij deri në muajin nëntor 2018, që korrespondonte me përfundimin e mandatit të tij të



ligjshëm në detyrë (shih paragrafin 4 më sipër). Gjykata rrëzoi pjesën tjetër të kërkesave. Të gjitha palët depozituan ankesa pranë Gjykatës së Lartë.

10. Më 12 korrik 2017, Gjykata e Lartë vendosi se në vend të shfuqizimit të vendimit të Parlamentit për shkarkimin e kërkesit nga detyra, ai vendim do të ishte absolutisht i pavlefshëm, ndërkohë la në fuqi pjesën e mbetur të vendimit të gjykatës më të ulët.

11. Më 30 janar 2018, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankesën kushtetuese të BQSH-së ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë.

KUADRI DHE PRAKTIKA LIGJORE PËRKATËSE

A. Ligji vendës

1. Kushtetuta

12. Neni 17 i Kushtetutës parashikon:

“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

13. Neni 35 i Kushtetutës parashikon:

“1. Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij.

2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

3. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.”

14. Neni 42§2 i Konventës parashikon se për të mbrojtur të drejtat kushtetuese dhe ligjore, liritë dhe interesat, ose në mbrojtje të një akuze penale ndaj tij/saj, kushdo ka të drejtën për një seancë të drejtë dhe publike, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar sipas ligjit.

15. Neni 44 i Kushtetutës parashikon:

“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është

dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.”

16. Neni 49§1 i Kushtetutës parashikon:

“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.”

17. Neni 122 i Kushtetutës parashikon:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.”

18. Neni 131 (f) i Kushtetutës, në fuqi përpara ndryshimeve në vitin 2016, parashikon si më poshtë:

“Gjykata Kushtetuese vendos, për:

...

f) ankesat e individëve që pretendojnë se iu janë shkelur të drejtat kushtetuese për një seancë të drejtë, pasi janë shteruar të gjitha mjetet për mbrojtjen e atyre të drejtave.”

19. Më 12 gusht 2016, ligji nr. 76/2016, i datës 22 korrik 2016, për disa ndryshime në Kushtetutë (“ligji ndryshues 2016”) hyri në fuqi pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare nr. 138, të datës 27 korrik 2016. Neni 131 (f) i Kushtetutës, i ndryshuar nga ligji ndryshues 2016, parashikon si më poshtë:

“Gjykata Kushtetuese vendos, për:

...

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë



shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.”.

2. *Ligji për Gjykatën Kushtetuese (ligji nr. 8577 i datës 10 shkurt 200 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016).*

20. Neni 71(ç) i ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i ndryshuar, që ka hyrë në fuqi më 1 mars 2017, parashikon të drejtën e ankuesit për të kërkuar shpërblim të drejtë nga Gjykata Kushtetuese në çështjet ku ankesa e tij/saj kushtetuese nuk dëgjohet brenda një afati të arsyeshëm.

21. Neni 76(6) i ligjit për Gjykatën Kushtetuese parashikon se vendimet gjyqësore që prishen nga Gjykata Kushtetuese do të konsiderohen të pavlefshëm *ab initio* dhe çështja do të dërgohet për rigjykim në gjykatën vendimi i së cilës është prishur.

B. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese

1. *Vendimi nr. 52 i datës 1 dhjetor 2011 (“vendimi nr. 52/2011”)*

22. Vendimi nr. 52/2011 i Gjykatës Kushtetuese kishte të bënte me kërkesën për një gjykim paraprak mbi kushtetueshmërinë paraqitur nga tri gjykata të zakonshme. Kërkesa e gjykatave referuese kishte të bënte, midis të tjerash, me pajtueshmërinë me të drejtën kushtetuese për të respektuar jetën private dhe familjare në një sërë dispozitash të ligjit nr. 10129, të datës 11 maj 2009, mbi gjendjen civile (ligji për Gjendjen Civile), që rregullojnë mënyrën sipas së cilës regjistrohej përkatësia etnike e individëve në regjistrin e statusit civil.

23. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, gjykata konstatoi se e drejta kushtetuese për të respektuar jetën private dhe familjare ishte mbrojtur nga një sërë dispozitash kushtetuese, duke përfshirë nenin 35 (mbrojtja e të dhënave personale), neni 36 (liria dhe konfidencialiteti i korrespondencës), neni 37 (papekshmëria e banesës) dhe neni 53 (mbrojtja e martesës dhe e familjes) e Kushtetutës (paragrafi 28 i vendimit). Gjithashtu, gjykata theksoi se e drejta për respektimin e jetës private mbrohej me anë të nenit 8 të Konventës, dhe e vijonte arsyetimin duke përcaktuar praktikën gjyqësore të zbatueshme të Gjykatës në mbështetje të atij neni.

24. Pasi identifikoi parimet e zbatueshme dhe pasi i zbatoi ato në rrethanat konkrete, Gjykata Kushtetuese i shpalli parashikimet në fjalë jokushtetuese.

2. *Vendimi nr. 17 i datës 15 mars 2016 (“vendimi nr. 17/2016”)*

25. Vendimi nr. 17/2016 i Gjykatës Kushtetuese kishte të bënte me një ankesë individuale sipas së cilës moszbatimi nga ana e autoriteteve i një vendimi që njihte të drejtën e ankuesit për të vizituar fëmijën e tij kishte shkelur nenin 6§1 dhe nenin 8 të Konventës. Gjatë shqyrtimit të ankesës në lidhje me moszbatimin e vendimit, përveç praktikës gjyqësore të Gjykatës në mbështetje të nenit 6§1, Gjykata Kushtetuese iu referua gjerësisht të drejtës së ankuesit për respektimin e jetës së tij familjare në mbështetje të nenit 8 të Konventës dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës sipas asaj dispozite. Në mbështetje të rrethanave, ajo konstatoi një shkelje të nenit 6§1 të Konventës dhe gjykoi se, duke qenë se pretendimet e kërkuarit në mbështetje të nenit 8 të Konventës ishin marrë në konsideratë për shqyrtimin e ankesës për moszbatim, nuk ishte e nevojshme që ankesa të gjykohej në mënyrë të veçantë sipas nenit 8.

3. *Vendimi nr. 80 i datës 18 dhjetor 2017 (“vendimi nr. 80/2017”)*

26. Vendimi nr. 80/2017 i Gjykatës Kushtetuese kishte të bënte, midis të tjerash, me një ankesë individuale, sipas së cilës shembja e pjesshme nga autoritetet e një banese dhe e murit të saj rrethues kishte shkaktuar shkeljen e nenit 8 të Konventës.

27. Gjatë shqyrtimit të pajtueshmërisë së ankesave *ratione materiae*, Gjykata Kushtetuese konstatoi se ato ishin *prima facie* brenda juridiksionit të saj (shih paragrafin 13 të vendimit), dhe se ankuesi, si mbajtësi i të drejtave përmbajtësores dhe procedurale, sipas interpretimit të nenit 131 (f) të Kushtetutës, kishte argumente për të bërë një ankesë individuale (paragrafi 11 i vendimit).

28. Në lidhje me meritat e ankesës sipas nenit 8 të Konventës, gjykata vlerësoi se vendimi i gjykatave të zakonshme se ndërtimi i ankuesit kishte qenë i paligjshëm, dhe për këtë arsye i pakualifikueshëm për kompensim pas shembjes, ishte i mbështetur në fakte (paragrafët 38 dhe 44 i vendimit). Ajo gjykoi se gjykatat e zakonshme i ishin përgjigjur në mënyrën e duhur ankesës mbështetur në të drejtën për respektimin e banesës së një personi, sipas nenit 8 të Konventës (paragrafi 45 i vendimit).



29. Një gjyqtar bashkëlidhi një opinion pjesërisht kundërshtues, ku theksonte se ndryshimet kushtetuese të muajit korrik 2016 (shih paragrafin 19 më sipër) kishin zgjeruar juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar ankesa në lidhje me të drejtat kushtetuese përmbajtjesore. Sipas këndvështrimit të opinionit kundërshtues, gjykata duhej të kishte realizuar një vlerësim më të thellë rreth pretendimeve të ankuesit bërë në mbështetje të nenit 8, veçanërisht në lidhje me proporcionalitetin dhe arsyeshmërinë e ndërhyrjes.

30. Një kërkesë në lidhje me atë çështje është pezull në Gjykatë (nr. 8706/18, komunikuar më 16 prill 2018).

4. *Vendimi nr. 7 i datës 12 janar 2021 ("vendimi nr. 7/2021")*

31. Vendimi nr. 7/2021 i Gjykatës Kushtetuese kishte të bënte me, midis të tjerash, një ankesë individuale sipas së cilës vendimi i gjykatave të zakonshme për të njohur të drejtën e një pale të tretë si trashëgimtarë të një anëtarit të familjes së ankuesit kishte shkaktuar shkelje të së drejtës së ankuesit për respektimin e jetës private dhe familjare në mbështetje të nenit 8 të Konventës.

32. Në përgjigje të asaj ankese, Gjykata Kushtetuese parashikoi parime të përgjithshme të zbatueshme për ankesën dhe arriti në përfundimin se kjo ankesë ishte haptazi e pabazuar.

5. *Vendimi nr. 38 i datës 2 dhjetor 2021 ("vendimi nr. 38/2021")*

33. Vendimi nr. 38/2021 i Gjykatës Kushtetuese kishte lidhje, midis të tjerash, me një ankesë individuale sipas së cilës vendimi i autoriteteve për të skualifikuar ankuesin që të hynte në rrugën e një karriere në gjyqësor kishte shkaktuar shkeljen e të drejtës së këtij të fundit për "jetë private sipas nenit 35 të Konventës". Ankuesi argumentoi se veprimet e autoriteteve kishin ndërhyrë në të drejtën e tij për të ushtruar një profesion dhe kishin prekur dinjitetin, personalitetin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të tij me botën e jashtme.

34. Në shqyrtimin e pretendimit për shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private, Gjykata Kushtetuese miratoi një qasje të ngjashme me atë qasje që e kishte miratuar në vitin 2011 (shih paragrafin 23 më sipër).

35. Ajo arriti në përfundimin se ankuesi nuk kishte provuar pretendimin e tij se ai kishte vuajtur pasoja negative nga vendimi konkret dhe, sipas

rrethanave, nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin aspektet nëse ndërhyrja e pretenduar ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, sipas ligjit, apo nëse ndërhyrja kishte ndjekur një qëllim legjitim. Për këtë arsye, gjykata e rrëzoi ankesën.

C. Kuadri në lidhje me zgjerimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese

36. Në vitin 2014, Parlamenti ngriti një komision parlamentar *ad hoc*, që do të ishte përgjegjës për reformën në sektorin e drejtësisë. Në muajin qershor 2015 komisioni miratoi një raport për vlerësimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri ("Raporti i vlerësimit; shih *Xhoxhajt kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, §4, 9 shkurt 2021").

37. Për sa ka të bëjë me çështjen konkrete, raporti i vlerësimit theksonte se sipas nenit 131 (f) të Kushtetutës, në fuqi në periudhën respektive, juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për ankesat individuale kufizohej te pretendimet në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë. Gjithashtu theksohet se, sipas rrethanave, Gjykata nuk kishte shqyrtuar ankesa përpara Gjykatës Kushtetuese si mjet efektiv për llojet e tjera të ankesave, dhe ky fakt kishte pasur ndikim në efektivitetin e Gjykatës Kushtetuese.

38. Raporti i vlerësimit shërbeu si baza për përgatitjen dhe miratimin e një strategjie për reformën në sistemin e drejtësisë ("Strategjia e Reformës"), si rezultat i së cilës në vitin 2016 u ndryshua Kushtetuta dhe hynë në fuqi një sërë statutesh të rëndësishëm (shih *Xhoxhajt*, cituar më sipër, §5).

39. Në Sesionin Plenar të 105-të (18–19 dhjetor 2015), Komisioni Evropian për Demokraci miratoi me anë të ligjit (Komisioni i Venecias) opinionin e ndërmjetëm nr. 824/2015 (CDL-AD(2015)045) për projekt-ndryshimet kushtetuese në sistemin gjyqësor në Shqipëri. Për sa ka të bëjë me çështjen konkrete, në opinion përcaktohej si më poshtë:

"30. Neni 22 [i projektligjit ndryshues] (që ndryshon nenin 131 [të Kushtetutës]) propozon ndryshimin e formulimit që parashikon juridiksionin e GJK-së [Gjykatës Kushtetuese] në lidhje me gjykimin e ankuesve individualë për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Në tekstin aktual, kompetenca e GJK-së kufizohej në parashikimin "gjykimi përfundimtar i ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese në procesin e rregullt ligjor". Nëse synimi i legjislatorëve është zgjerimi i kompetencës



së GJK-së me ankesat që kanë lidhje me të drejta dhe liri të tjera bazë, kjo gjë duhet të mirëpritet [është hequr shënimi fundor]).”.

40. Pjesët përkatëse të raportit shpjegues për ligjin ndryshues 2016 përshkruanin arsyetimin në lidhje me ndryshimin e nenit 131 (f) të Kushtetutës për aspektet në vijim:

“formulimet e disa dispozitave të caktuara që rregullonin juridiksionin e [Gjykatës Kushtetuese]... çuan në ankesat se [Gjykata Kushtetuese] nuk do të ishte një mjet efektiv në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, siç theksohet në vendime të caktuara të [Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut].

...

[Për këtë arsye propozohet] zgjerimi i juridiksionit të [Gjykatës Kushtetuese] me qëllim mbështetjen në mënyrë efektive të të drejtave individuale. Sugjerohet që të bëhen një sërë ndryshimesh që orientohen drejt zgjerimit të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese [konkretisht]... zgjerimi i [fushës së veprimtimit të] ankesës individuale kushtetuese që duhet të riformulohet me qëllim ofrimin e një mbrojtjeje më të mirë për individët nga veprimet e autoriteteve publike (modeli gjerman – *Verfassungsbeschwerde*).”.

D. Materiale të tjera në lidhje me çështjen

41. Konferenca e Gjykatave Kushtetuese Evropiane (“KGJKE”) është një forum sipas së cilës gjykatat kushtetuese evropiane dhe institucione të tjerë evropiane që ushtrojnë juridiksion kushtetues organizojnë vazhdimisht konferenca të specializuara me qëllim ndarjen e eksperiencave në lidhje me praktikën dhe jurisprudencën kushtetuese.

42. Kongresi XVIII i KGJKE-së u zhvillua më 24–25 shkurt 2021 në Pragë dhe tema e tij ishte “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore: marrëdhënia e katalogëve ndërkombëtarë, mbikombëtarë dhe kombëtarë në shekullin XXI”. Secila prej gjykatave pjesëmarrëse kushtetuese, duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë, paraqiti një raport kombëtar mbi atë tematikë duke iu përgjigjur pyetjeve që i ishin dërguar paraprakisht secilës gjykatë pjesëmarrëse. Për sa ka të bëjë me çështjen konkrete, raporti kombëtar i Shqipërisë, që u dorëzua në një datë të paspecifikuar në vitin 2019, përcaktonte:

“Çfarë mekanizmi përdoret për të përfshirë traktatet ndërkombëtare në [mosmarrëveshjet vendëse]?

...

Konventa Evropiane [për të Drejtat e Njeriut] ka status mbikombëtar dhe nënkushtetues në [sistemin juridik në Shqipëri]... Çdokush ka të drejtën të depozitojë një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe sistemit të gjykatave të zakonshme për mbrojtjen e të drejtave individuale, duke iu referuar masave të saj në mënyrë të drejtpërdrejtë.¹”.

LIGJI

43. Kërkuesi u ankua se refuzimi i gjykatave vendëse për ta rikthyer në detyrë apo për t’i dhënë kompensim shtesë për dëmin jopasuror për dëmin e shkaktuar ndaj reputacionit dhe nderit të tij si rezultat i shkarkimit të tij nga detyra përbënte shkelje të së drejtës së tij për respektimin e jetës së tij private sipas nenit 8 të Konventës.

44. Neni 8 i Konventës parashikon si më poshtë:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”.

A. Kundërshtim për mosshërim të mjeteve vendëse

1. Parashtrimet e palëve

a) Qeveria

45. Qeveria parashtroi se në vitin 2016 Parlamenti kishte miratuar reformën në drejtësi, që kishte të bënte, midis të tjerash, me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Përpara reformës, juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për ankesa individuale kufizohej tek ankesat që pretendonin për shkelje të së drejtës për një seancë të drejtë, ndërsa në vitin 2016, individët mund të ankoheshin pranë një gjykate për një shkelje të cilësdo të drejte

¹ [Http://www.cecc2017-2020.org/fileadmin/Dokumenty/Pdf/Questionnaire/National_Reports/English/Albania_-_Questionnaire_XVIII_Congress_of_CECC_eng.pdf](http://www.cecc2017-2020.org/fileadmin/Dokumenty/Pdf/Questionnaire/National_Reports/English/Albania_-_Questionnaire_XVIII_Congress_of_CECC_eng.pdf)



kushtetuese, duke përfshirë të drejtën për respektimin e jetës private.

46. Në përputhje me rrethanat, Qeveria u mbështet në versionin e amenduar të nenit 131 (f) të Kushtetutës (shih paragrafin 19 më sipër) dhe nenet 76 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese (shih paragrafin 21 më sipër) për të vlerësuar nëse kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet vendëse duke paraqitur një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese. Në lidhje me shkaqet përmbajtjesore të një ankese të mundshme pranë gjykatës, Qeveria argumentoi se i takonte kërkuesit të mbështetej në të drejtat e tij për dëmshpërblim dhe për punësim të ligjshëm sipas neneve 44 dhe 49§1 të Kushtetutës (shih paragrafët 15–16 më sipër) respektivisht.

47. Në lidhje me praktikën gjyqësore në mbështetje të përcaktimit të mësipërm, Qeveria u shpreh se ndryshimi në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ankesat individuale kishte qenë në fuqi për një periudhë të shkurtër, gjë që shpjegonte se përse nuk ekzistonte një praktikë gjyqësore e mirëpërcaktuar mbi këtë çështje.

48. Gjithashtu, si përgjigje ndaj pretendimeve të kërkuesit (shih paragrafin 53 në vijim), Qeveria parashtroi se Gjykata Kushtetuese kishte pasur kuorumin për të gjykuar mbi një ankesë të mundshme të depozituar nga kërkuesi dhe në çdo rast, nëse do të kishte pasur vonesa në shqyrtimin e ankesës, neni 71 (ç) i ligjit për Gjykatën Kushtetuese (shih paragrafin 20 më sipër) parashikonte të drejtën për të përfituar kompensim për shkeljen e parashikimit për “afat të arsyeshëm”.

49. Së fundmi, Qeveria parashtroi se duke qenë se gjykatat vendëse e kishin anuluar shkarkimin e kërkuesit nga detyra, dhe i kishin akorduar mjaftueshëm dëmshpërblime, kërkuesi nuk kishte statusin e viktimës sipas nenit 34 të Konventës. Gjithashtu, Qeveria parashtroi se ankesa ishte haptazi e pabazuar.

b) Kërkuesi

50. Fillimisht kërkuesi parashtroi se ankesa e tij vinte si pasojë e mungesës së legjislacionit të dukur vendës në lidhje me të drejtën e tij për rikthimin në detyrë, dhe Gjykata Kushtetuese nuk kishte mundësi të zgjidhte atë situatë.

51. Së dyti, sipas këndvështrimit të tij, fakti se ndryshimet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese kishin qenë në fuqi vetëm për një periudhë të shkurtër nuk mund ta çlironte Qeverinë nga detyrimi paraqitjen e një praktike gjyqësore të

konsoliduar në mbështetje të pretendimit të saj se një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese ishte një mjet efektiv për ankesat sipas nenit 8 të Konventës. Përkundrazi, sipas opinionit të kërkuesit, risia e mjetit duhet të shërbente si arsye për ta përjashtuar kërkuesin nga mundësia për të përdorur mjetin e ri të pretenduar.

52. Së treti, kërkuesi parashtroi se edhe pse juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese ishte ndryshuar, të drejtat përmbajtjesore kushtetuese nuk ishin amenduar dhe nuk ekzistonte asnjë e drejtë kushtetuese për rikthimin në detyrë ose për përfitimin e kompensimit për dëmin jopasuror.

53. Së fundmi, kërkuesi parashtroi se funksionimi i Gjykatës Kushtetuese gjatë periudhës përkatëse ishte ndërprerë nga dorëheqjet dhe shkarkimet në gjyqësor dhe nga vonesat nga ana e autoriteteve në emërimin e gjyqtarëve të rinj. Ai theksoi veçanërisht një periudhë gjatë së cilës gjykata nuk kishte pasur kuorumin për të vendosur mbi çfarëdo çështjeje.

54. Për të gjitha arsyet e sipërpërmendura, në këndvështrimin e kërkuesit, një ankesë kushtetuese përpara Gjykatës Kushtetuese nuk mund të konsiderohet si mjet efektiv për ankesën e tij sipas nenit 8 të Konventës.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parimet e përgjithshme

55. Ekziston një karakteristikë themelore e makinerisë së mbrojtjes e vendosur nga Konventa në mbështetje të sistemeve vendëse që mbrojnë të drejta e njeriut. Gjykata mbikëqyr zbatimin nga ana e Shteteve Kontraktuese të detyrimeve të tyre sipas Konventës. Ajo nuk duhet të marrë rolin e Shteteve Kontraktuese përgjegjësia e të cilave është të garantojnë se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Konventë respektohen dhe mbrohen në nivel të kombëtar.

Rregulli për shterimin e mjeteve vendëse mbështetet në prezumimin – reflektuar në nenin 13 të Konventës, me të cilin ka ngjashmëri të ngushtë – se ekziston një mjet efektiv i disponueshëm për shkeljen e pretenduar. Për këtë arsye, rregulli është një pjesë e rëndësishme e funksionimit të këtij sistemi mbrojtjeje (shih *Vučković dhe të tjerë kundër Serbisë* (kundërshtimi paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §69, 25 mars 2014).

56. Shtetet janë përjashtuar nga kërkesa për t'u përgjigjur përpara një organi ndërkombëtar për veprimet e tyre deri sa të kenë pasur mundësinë për



t'i zgjidhur çështjet me anë të sistemit të tyre ligjor, dhe ato shtete që duan të kërkojnë juridiksionin mbikëqyrës të Gjykatës në lidhje me ankesat ndaj një Shteti janë të detyruara të përdorin fillimisht mjetet e ofruara nga sistemi ligjor vendës (shih, midis shumë autoritetesh të tjerë, *Akdivar dhe të tjerë kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, §65, *raportet* 1996-IV, dhe *Vučković dhe të tjerë*, cituar më sipër, §70).

57. Për këtë arsye, detyrimi për të shteruar mjetet vendëse parashikon që kërkuesit duhet të përdorin normalisht mjetet që janë të disponueshme dhe të mjaftueshme në lidhje me ankesat e tyre sipas Konventës. Ekzistenca e mjeteve konkrete duhet të jetë mjaftueshme e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, në të kundërt këto mjete nuk do të kenë aksesueshmërinë dhe efektivitetin e nevojshme (shih *Akdivar dhe të tjerë*, cituar më sipër, §66, dhe *Vučković dhe të tjerë*, cituar më sipër, §71). Për të qenë efektiv, një mjet duhet të zgjidhë drejtpërdrejtë situatën dhe duhet të ofrojë perspektiva të arsyeshme suksesi (shih *Sejđović kundër Italisë* [DHM], nr. 56581/00, §46, GJEDNJ 2006-II; *Vučković dhe të tjerë*, cituar më sipër, §74; dhe *Balogh kundër Hungarisë*, nr. 47940/99, 30, 20 korrik 2004).

58. Nuk ekziston ndonjë detyrim për rekurs për mjetet që janë të papërshtatshme ose joefektive (shih *Akdivar dhe të tjerë*, cituar më sipër, §67, dhe *Vučković dhe të tjerë*, cituar më sipër, §73). Megjithatë, ekzistenca e dyshimeve në lidhje me perspektivën e suksesit të një mjeti të caktuar që nuk është qartazi i pavlerë, nuk është një arsye e vlefshme për të mos e ndjekur atë (shih *Akdivar dhe të tjerë*, cituar më sipër, §71; *Scoppola kundër Italisë* (nr. 2) [DHM], nr. 10249/03, §70, 17 shtator 2009; dhe *Vučković dhe të tjerë*, cituar më sipër, §74).

59. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar vazhdimisht nevojën për të zbatuar rregullin e shterimit me një nivel të caktuar fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepërt (shih *Ringeisen kundër Austrisë*, 16 korrik 1971, §89, seritë A nr. 13; *Akdivar dhe të tjerë*, cituar më sipër, §69; dhe *Vučković dhe të tjerë*, cituar më sipër, §76). Në vijim, ajo ka pranuar se rregulli i shterimit nuk është as absolut dhe as nuk mund të zbatohet në mënyrë automatike; gjatë shqyrtimit nëse ky rregull është zbatuar, është e rëndësishme që të merren në konsideratë rrethanat specifike të secilës çështje individuale (shih *Akdivar dhe të tjerë*, cituar më sipër, §69, dhe *Kurić dhe të tjerë kundër Sllovenisë*

[DHM], nr. 26828/06, §286, GJEDNJ 2012 (ekstrakte)).

60. Në lidhje me barrën e provës, është detyrë e Qeverisë që pretendon mosshfrytëzimin që të bindë Gjykatën se mjeti ishte efektiv, i disponueshëm në teori dhe në praktikë në periudhën përkatëse. Vlefshmëria e një mjeti për të cilin thuhet se ekziston, duke përfshirë qëllimin dhe zbatimin e tij, duhet të parashikohet qartë dhe të konfirmohet ose të plotësohet me anë të praktikës ose praktikës gjyqësore (shih *McFarlane kundër Irlandës* [DHM], nr. 31333/06, §§117 dhe 120, 10 shtator 2010, dhe *Mikolajová kundër Sllovakisë*, nr. 4479/03, §34, 18 janar 2011).

61. Pasi kjo barrë të jetë justifikuar, i takon kërkuesit që të provojë se mjeti i ofruar nga Qeveria faktikisht është përdorur, ose për disa arsye ka qenë i papërshtatshëm dhe joefektiv në rrethanat e caktuara të çështjes, apo se kanë ekzistuar rrethana të veçanta që e përjashtonin atë nga kjo kërkesë (shih *Akdivar dhe të tjerë*, cituar më sipër, §68, *Demopoulos dhe të tjerë kundër Turqisë* (vendim) [DHM], nr. 46113/99 dhe 7 të tjerë, §69, GJEDNJ 2010; dhe *Vučković dhe të tjerë*, cituar më sipër, §77).

b) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen konkrete

62. Palët nuk ranë dakord për vlefshmërinë e mjetit që kishte të bënte me një ankesë kushtetuese për dy arsye kryesore: ekzistenca e një shkakut material për ankesën dhe vlefshmëria e tij nga këndvështrimi procedural. Për këtë arsye, Gjykata do t'i shqyrtojë këto aspekte me radhë.

i) Shkaqet materiale për ankesë përpara Gjykatës Kushtetuese

63. Gjykata vëren, pa shprehur një opinion mbi çështjen, se ankesa e kërkuesit përpara Gjykatës nënkupton se e drejta për respektimin e jetës private sipas nenit 8 të Konventës përfshin të drejtën për t'u rikthyer në detyrë në një pozicion të lartë pasi është emëruar dhe shkarkuar nga detyra nga parlamenti, si edhe të marrë dëmshpërblim në rastin e një shkarkimi të padrejtë nga një pozicion i tillë. Kërkuesi parashtrroi se kjo ankesë nuk mund të dëgjohet nga Gjykata Kushtetuese pasi nuk ekzistonte një e drejtë përmbajtjesore kushtetuese tek e cila ai mund të mbështetej përpara asaj gjykate. Megjithatë, kërkuesi nuk parashtrroi argumente të detajuar për të rrëzuar pretendimin e Qeverisë ai mund të ishte mbështetur në nenet 44



dhe 49§1 të Kushtetutës (shih paragrafët 15–16 më sipër). Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata konstaton ndonjë element që mund të sugjerojë se linja e veprimeve e parashtruar nga Qeveria ishte qartazi e pavlerë.

64. Gjithashtu, Gjykata vëren se Gjykata Kushtetuese i ishte referuar ekzistencës së të drejtës kushtetuese për respektimin e jetës private në vitin 2011, kur kishte shqyrtuar një kërkesë për një vendim paraprak mbi kushtetueshmërinë (shih paragrafin 22 më sipër) si edhe në praktikën e saj gjyqësore të mëpasshme për çështje individuale (shih paragrafët 25, 31 dhe 33 më sipër). Në këto vendime, gjykata njihte të drejtën për respektimin e jetës private sipas, midis të tjerash, nenit 35 të Kushtetutës (shih paragrafin 13 më sipër).

65. Më i rëndësishëm është fakti se një shqyrtim i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese tregon se si ankuesit edhe vet gjykata i referohen vazhdimisht në mënyrë të drejtpërdrejtë Konventës dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës (shih paragrafët 25–34 më sipër). Mundësia për t'iu referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë parashikimeve të Konventës përpara Gjykatës Kushtetuese referohet edhe në raportin vendës të gjykatës të paraqitur në Kongresin XVIII të KGJKE-së (shih paragrafin 42 më sipër), edhe pse nuk ka efekt detyrues, ai paraqet një pjesë të kontekstit në lidhje me çështjen. Gjithashtu, sipas paragrafit të dytë të nenit 17 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, çdo kufizim i të drejtave kushtetuese të njohura nuk mund të shkojë përtej kufizimeve të lejueshme sipas Konventës.

66. Sipas rrethanave, Gjykata nuk mund të bjerë dakord me argumentin e kërkuarit se nuk ekziston asnjë e drejtë përmbajtësore tek e cila ai mund të mbështetet përpara Gjykatës Kushtetuese për të depozituar një ankesën që tashmë është përpara Gjykatës. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, si edhe në mbështetje të ligjit dhe praktikës gjyqësore vendëse, i takon kërkuarit që t'i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nenit 8 të Konventës përpara Gjykatës Kushtetuese në pretendimin për shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private.

ii) *Vlefshmëria procedurale e një anekse përpara Gjykatës Kushtetuese*

67. Gjykata vëren se në vitin 2016, juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese, që deri në atë moment ishte i kufizuar deri tek ankesat sipas së cilave pretendohet për shkeljen e të drejtës për dëgjim të

drejtë, ishte zgjeruar duke përfshirë ankesat sipas së cilave pretendohet për shkeljen e çdo të drejte kushtetuese (shih paragrafët 18 dhe 19 më sipër për një krahasim të formulimit të nenit 131 (f) përpara dhe pas ndryshimit të vitit 2016). Kërkuari nuk kundërshtoi formulimin e atij neni.

68. Gjithashtu, nga raporti shpjegues për ligjin ndryshues 2016 (shih paragrafin 40 më sipër) dhe konteksti i përgjithshëm në të cilin u miratua (shih paragrafin 37 më sipër), rezulton se zgjerimi i juridiksionit për ankesat individuale të Gjykatës Kushtetuese hyri në fuqi, të paktën pjesërisht, si përgjigje ndaj vendimeve të Gjykatës, sipas së cilave gjykohej se një ankesë përpara Gjykatës Kushtetuese ishte një mjet efektiv vetëm për ankesat sipas nenit 6 të Konventës (shih *Balliu kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 74727/01, 30 shtator 2004, dhe *Jakupi kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 11186/03, 1 dhjetor 2009).

69. Sipas sa më sipër, nuk ka dyshime se mjeti ekzistues në ankesën kushtetuese ishte i disponueshëm në teori.

70. Për sa i përket vlefshmërisë praktike të mjetit, Gjykata thekson se në një sistem ligjor ku të drejtat themelore mbrohen nga Kushtetuta dhe ligji, i takon ankuesit të testojë shtrirjen e asaj mbrojtjeje, dhe të lejojë gjykatat vendëse t'i zbatojnë ato të drejta, dhe, ku është e mundur, t'i zhvillojnë ato duke ushtruar fuqinë e tyre për interpretim (shih, *mutatis mutandis*, *A.B dhe V kundër Irlandës* [DHM], nr. 25579/05, §GJEDN] 2010). Për këtë arsye, nëse kërkuari kishte ndonjë dyshim për efektivitetin e një ankesë përpara Gjykatës Kushtetuese, i takonte atij t'i shuante ato dyshime duke depozituar një ankesë përpara asaj gjykate.

71. Gjithashtu, Gjykata i ka dhënë vëmendje të veçantë mjeteve që janë përdorur nga Shtetet e paditura si përgjigje ndaj një vendimi pilot të Gjykatës (shih, për shembull, *Balan kundër Republikës së Moldavisë* (vendim), nr. 44746/08, 24 janar 2012, dhe *Nagovitsyn dhe Nalçayev kundër Rusisë* (vendim), nr. 27451/09 dhe 60650/09, 23 shtator 2010 në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve; *Stella dhe të tjerë kundër Italisë* (vendim), nr. 49169/09 dhe 10 të tjerë, 16 shtator 2014, dhe *Latak kundër Polonisë* (vendim), nr. 52070/08, 12 tetor 2010 në lidhje me mbipopullimin e burgut; *Techniki Olympiki A.E. kundër Greqisë* (vendim), nr. 40547/10, 1 tetor 2013; *Balachev dhe të tjerë kundër Bullgarisë* (vendim), nr. 65187/10, 18 qershor 2013,



dhe *Müdiir Turgut dhe të tjerë kundër Turqisë* (vendim), nr. 4860/09, 26 mars 2013 në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve; dhe *Hodžić kundër Sllovenisë* (vendim), nr. 3461/08, 4 prill 2017 në lidhje me kursimet në monedhë të huaj “të vjetër”). Në situata të ngjashme, Gjykata i ka dhënë rëndësi të veçantë çështjes nëse mjeti i sapokrijuar ishte parimisht i përshtatshëm dhe efektiv (shih, për shembull, *Shmelev dhe të tjerë kundër Rusisë* (vendim), nr. 41743/17 dhe 16 të tjerë, §119, 17 mars 2020).

72. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, qasja e mësipërme ka lidhje me çështjen konkrete në aspektin se edhe pse Gjykata nuk ka dhënë ende një vendim pilot, autoritetet vendëse e zgjeruan juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese në një pjesë të madhe si përgjigje ndaj praktikës gjyqësore të Gjykatës.

73. Së fundmi, Gjykata vëren edhe se, në kundërshtim me parashtrimet e kërkuarit, Gjykata Kushtetuese kishte filluar të shpallte vendimet e saj të para për shkeljet e pretenduara të drejtave përmbajtësore kushtetuese. Në të vërtetë, në periudhën midis datës 12 gusht 2016, kur hyri në fuqi ligji ndryshues 2016 (shih paragrafin 19 më sipër), dhe datës 18 janar 2018, kur kërkuari paraqiti kërkesën e tij në Gjykatë, Gjykata Kushtetuese nxori vendimin nr. 80/2017 (shih paragrafin 26 më sipër). Edhe pse ai vendim nuk kishte të bënte në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtën për respektimin e jetës private, në atë rast Gjykata Kushtetuese e deklaroi të pranueshme një kërkesë ku përfshihej e drejta për respektimin e banesës së dikujt, që garantohet edhe nga neni 8 i Konventës. Në vijim, rezultoi se, të paktën në thelb, Gjykata Kushtetuese e shqyrtoi atë ankesë sipas themelit të saj, ku shumica gjykoj se kërkesa ishte haptazi e papabazuar, kurse një gjyqtar kundërshtues deklaroi se ankesa duhej të ishte shqyrtuar në më shumë detaje (shih paragrafin 29 më sipër).

74. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, vendimi konkret ofron mbështetje për pretendimin e Qeverisë se në praktikë, Gjykata Kushtetuese kishte filluar të pranonte për shqyrtim ankesa që mbështeteshin te, ose i përkisnin fushës së veprimit të, neni 8 të Konventës, duke iu shtuar parashikimeve kushtetuese. Pas vendimit të sipërpërmendur, Gjykata Kushtetuese nxori vendimet nr. 7/2021 dhe 38/2021 ku ajo shqyrtonte edhe ankesat që pretendoheshin se i

përkisnin fushës së veprimit të neni 8 të Konventës (shih paragrafët 31–35 më sipër).

iii) Rrethana të tjera që përjashtonin kërkuarin nga depozitimi i një ankesë kushtetuese

75. Kërkuari argumentoi se ankesa e tij vinte si pasojë e mungesës së legjislacionit të duhur vendës dhe se Gjykata Kushtetuese nuk mund ta korrigjonte atë situatë. Megjithatë, Gjykata vëren se Gjykata Kushtetuese ka fuqinë që të prishë vendimet e Gjykatës së Lartë (shih paragrafin 21 më sipër) dhe të urdhërojë rigjykimin e çështjes duke iu referuar udhëzimeve të asaj gjykate dhe çdo argumenti të mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë në Konventë (shih për zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të Konventës në Shqipëri paragrafin 17 më sipër dhe *Bakin dhe të tjerë kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 43928/13 dhe 16 të tjerë, §80, 10 prill 2018). Për këtë arsye, Gjykata nuk është e bindur se një ankesë përpara Gjykatës Kushtetuese ishte *a priori* një mjet joefektiv me prezumimin se ajo nuk mund të ofronte zgjidhje për ankesën e kërkuarit.

76. Gjithashtu, kërkuari parashtroi se fakti që ndryshimi në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese kishte qenë në fuqi për një periudhë të shkurtër kohore kur ai depozitoi kërkesën konkrete duhej të vepronte në favor të përjashtimit të tij nga detyrimi për të përdorur atë mjet. Gjykata vëren se ndryshimi në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese hyri në fuqi më 12 gusht 2016 (shih paragrafin 19 më sipër) dhe kërkesa konkrete u depozitua në Gjykatë afërsisht shtatëmbëdhjetë muaj më vonë, më 18 janar 2018. Sipas parimit se “injorimi i ligjit nuk është justifikim”, Gjykata gjykon se kërkuari nuk ishte i liruar nga përgjegjësia për t’u njohur me Kushtetutën, dhe nëse do të ishte e nevojshme duhej të ishte kërkuar ndihmë me anë të këshillimit ligjor (shih *Leki kundër Sllovenisë* [DHM], nr. 36480/07, §92, 11 dhjetor 2018, dhe *K.H.W. kundër Gjermanisë* [DHM], nr. 37201/97, §73, GJEDNJ 2001 II (ekstrakte)).

77. Si përgjigje ndaj argumentit se Gjykata Kushtetuese kishte qenë jofunksionale për një kohë të gjatë pasi i mungonte kuroumi në periudhën respektive, Gjykata thekson se BQSH-ja, që ishte njëri nga të paditurit në procedurat gjyqësore të ndërmarra nga kërkuari, depozitoi një ankesë kushtetuese dhe mori një vendim për pretendimet e saj (shih paragrafin 11 më sipër). Sipas këndvështrimit të Gjykatës, ky fakt është i



mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se pavarësisht numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në periudha të ndryshme, e njëjta rrugë ishte e hapur edhe për kërkuesin.

iv) Përfundim

78. Mbështetur në sa më sipër, duke marrë në konsideratë kontekstin që çoi ndryshimin e nenit 131 (f) të Kushtetutës, mungesa e një kundërshtimi në lidhje me formulimin e tij dhe me vendimet e Gjykatës Kushtetuese të diskutuara më sipër, Gjykata nuk mund të jetë dakord me argumentin e kërkuesit se atij nuk i është kërkuar që të depozitojë një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese.

79. Sipas rrethanave, Gjykata arrin në përfundimin se pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, një ankesë kushtetuese individuale nuk kufizohet brenda ankesave të nenit 6 të Konventës dhe, në parim, është një mjet efektiv në lidhje me ankesat sipas së cilave pretendohet për çfarëdo shkeljeje të të drejtave të mbrojtura nga Konventa dhe protokollet e saj që janë ratifikuar nga Shqipëria. Për këtë arsye, ky mjet duhet të përdoret nga kërkuesit përpara se ata të depozitojnë një kërkesë në Gjykatë.

80. Duke qenë se kërkuesi nuk ka depozituar një ankesë përpara Gjykatës Kushtetuese, rezulton se kundërshtimi i Qeverisë për mosshfrytëzim të mjeteve vendëse duhet të lihet në fuqi dhe kërkesa duhet të rrëzohet sipas nenit 35§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshfrytëzim të mjeteve vendëse.

B. Kundërshtime të tjera për pranueshmërinë

81. Qeveria parashitroi se kërkuesi nuk kishte statusin e viktimës sipas nenit 34 të Konventës, dhe se në mbështetje të nenit 35§3 (a), kërkesa ishte haptazi e pabazuar. Duke marrë në konsideratë përfundimin e mësipërm, Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme që të shqyrtojë këto kundërshtime.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,
E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim, më datë 13 tetor 2022.

Milan Blaško **Georges Ravarani**
SEKRETAR KRYETAR

**GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT**

**SEKSIONI I TRETË
VENDIM**

Kërkesa nr. 24650/15

**FLORESHA KALEMAJ KUNDËR
SHQIPËRISË**

(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 8 shtator 2022, si një Komitet i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar*

Darian Pavli,

Frédéric Krenc, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e
përkohshme e Seksionit,*

duke marrë në konsideratë kërkesën e mësipërme të depozituar më 18 maj 2015,
pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Kërkuesja, znj. Floresha Kalemaj, ka lindur në vitin 1962. Ajo u përfaqësua nga znj. I. Harka, një avokate që e ushtron profesionin në Tiranë.

Ankesat e kërkueses bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1, të Protokollit nr. 1 të Konventës, në lidhje me ekzekutimin e vonuar të një vendimi vendas, iu komunikuan Qeverisë Shqiptare (“Qeveria”), procedura për zgjidhje miqësore u vu në lëvizje me anë të zyrës së sekretarit pas komunikimit, ndjekur nga një deklaratë e njëanshme e paraqitur nga Qeveria.

Gjykata nuk mori asnjë përgjigje nga përfaqësuesja e kërkueses brenda afateve të parashikuara.

Me anë të shkresës së dërguar me postë rekomande, përfaqësuesja e kërkueses u njoftua se Gjykata nuk kishte marrë përgjigje brenda afatit të caktuar për paraqitjen e përgjigjes së tij. Në vijim, ajo theksoi nenin 37 § 1 (a) të Konventës, që parashikon se Gjykata mund ta përjashtojë një kërkesë nga lista e çështjeve në rastin kur rrethanat çojnë në përfundimin se kërkuesi nuk ka për qëllim ta ndjekë kërkesën. Shkresa nuk mund të dërgohej, sepse përfaqësuesja kishte ndryshuar adresën dhe nuk kishte njoftuar Sekretarinë për këtë gjë.



LIGJI

Për sa më sipër, në mungesë të korrespondencës nga kërkuesja ose përfaqësuesja e saj për rreth katër vite dhe duke pasur në konsideratë se pas komunikimit të kërkueses me Qeverinë, në Sekretari nuk ishte marrë asnjë shkresë dhe se shkresa më e fundit ishte kthyer në Gjykatë, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi mund të konsiderohet se nuk dëshiron që të ndjekë kërkesat (neni 37 § 1 (a) i Konventës). Gjithashtu, sipas nenit 37 § 1 *in fine*, Gjykata nuk konstaton rrethana të posaçme, në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut sipas parashikimit në Konventë dhe

Protokolleve të saj, që kërkojnë shqyrtimin e vazhdueshëm të kërkesës.

Për sa më sipër, është me vend që çështja të përjashtohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos ta përjashtojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 29 shtator 2022.

Viktoriya Maradudina

ZËVENDËSSEKRETARE

E PËRKOHSHME

Andreas Zünd

KRYETAR



SHTOJCË

KËRKESË QË NGRE ANKESA SIPAS NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS
(mosekzekutimi ose ekzekutimi i vonuar i vendimeve vendase)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkueses Viti i lindjes	Emri i përfaqësueses dhe adresa	Ankesa të tjera sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar	Data e shkresës së fundit të Gjykatës	Data e përpjekjes për të dorëzuar shkresën e Gjykatës nga Shërbimi i Postës Shqiptare
24650/15 18.5.2015	Floresha KALEMAJ 1962	Iva Harka 1962	Prot. 1, neni 1, ndërhyrje në gëzimin paqësor të pasurive si rezultat i mosekzekutimit të vendimit në favor të kërkuessit	3.2.2022	18.2.2022

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 65774/14

**DASHURI LLAGAMI DHE TË TJERË
KUNDËR SHQIPËRISË**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 6 dhjetor 2022 si një Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar*,

Jolien Schukking,

Darian Pavli, *gjyqtarë*,dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretar i Seksionit*,
duke marrë në konsideratë:

kërkesën (nr. 65774/14) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 18 shtator 2014 nga kërkuesit listuar në tabelën bashkëlidhur (“kërkuesit”), të cilët u përfaqësuan nga z. A. Kashahu, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar në lidhje me ankesën sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me shumën e kompensimit për shpronësimin e pronës së kërkuesve Qeverinë Shqiptare (“Qeveria”), e përfaqësuar nga Agjenti i saj i asaj periudhë, znj. B. Lilo, dhe në vijim nga Z.O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, dhe për të deklaruar të papranueshme pjesën e mbetur të kërkesës;

vërejtjet e palëve;

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me një padi të bërë në mbështetje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës se kompensimi për tokën e shpronësuar duhet të përlllogaritet mbështetur në vlerën e tokës në fund të procedurave të shpronësimit.

A. Rrethanat e çështjes

2. Në vitin 2001, Ministria e Transportit nisi procedurat e shpronësimit për një truall në Tiranë që i përkiste kërkuesve. Qëllimi i shpronësimit ishte për ndërtimin e një unaze të re për qytetin dhe çmimi për metër katror (m²) të pronës së

shpronësuar u përcaktua nga një komision i brendshëm në Ministri në vlerën 5,000 lekë shqiptarë (ALL). Kompensimi në total për 11,240 m² për shpronësim ishte 56,200,000 ALL. Kërkuesit u informuan për procedurat dhe nuk kundërshtuan ndonjë aspekt të tyre.

3. Në muajin gusht 2002, autoritetet anuluan procedurën e shpronësimit me argumentin se pas një rishikimi të brendshëm kishte rezultuar se titulli i pronësisë së kërkuesve ishte i paligjshëm. Rezultoi se punimet e ndërtimit për rrugën vijuan.

4. Më 26 mars 2004, kërkuesit nisën një proces ligjor ndaj Ministrisë së Transportit. Ata argumentuan se autoritetet kanë ndërtuar një rrugë në tokën e tyre dhe kërkuan “pagesën e shumës për paditësit për shpronësimin e tokës së tyre”.

5. Më 14 prill 2005, kërkuesit bënë shpjegime shtesë për padinë në gjykatë duke pretenduar se titulli i tyre i pronësisë për truallin ishte i ligjshëm. Gjithashtu, ata shpjeguan se vlerësimi fillestar i tokës dhe aktet e tjerë në lidhje me shpronësimin (shih paragrafin 2 më sipër) përputheshin me ligjin e zbatueshëm. Sipas këndvështrimit të tyre, anulimi i procedurës së shpronësimit ishte i paligjshëm dhe i kërkuan gjykatës të finalizonte procedurën duke u akorduar atyre “shumën që duhej t’u paguhej për shpronësimin”.

6. Më 5 korrik 2005, Gjykata e Rrethit Tiranë rrëzoi padinë me argumentin se procesi ligjor ishte i hapur vetëm për paditësit për të cilët procedura e shpronësimit ishte plotësuar me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave. Megjithatë, më 20 qershor 2006, Gjykata e Apelit Tiranë e prishi atë vendim, duke argumentuar se kishte pasur një sërë shkeljesh.

7. Pas rigjykimit, më 5 tetor 2007, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi masën përsëri, duke u mbështetur kryesisht në të njëjtat argumente si në vendimin e saj të parë (shih më sipër). Kërkuesit apelian.

8. Në një datë të paspecifikuar, Gjykata e Rrethit Tiranë caktoi një ekspert për të përcaktuar sipërfaqen e saktë të pronës së kërkuesve që ishte zënë nga rruga e sapondërtuar.

9. Ndërkohë, më 13 shkurt 2008, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 139 (“VKM 139”) për vlerën e pronave në rajone të ndryshme që u publikua në Fletoren Zyrtare të datës 25 shkurt 2008 dhe hyri në fuqi në po këtë datë. Sipas kërkuesve (shih paragrafin 14 më poshtë), në



mbështetje të VKM-së nr. 139, pronat në atë zonë ku gjendej prona e kërkuarve vlerësoheshin në shumën 26,787 ALL për m².

10. Gjithashtu, më 21 shkurt 2008, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 206 (“VKM 206”) me anë të së cilit u shpronësuar një sërë trojesh që u përkisnin kërkuarve me qëllimin e zgjerimit të trotuarit të rrugës së saponjërtuar. Sipas VKM 206, kërkuarve u dha e drejta për kompensim në vlerën prej 12,335 ALL për m². Kërkuarët nuk kundërshtuan as për sipërfaqen e tokës së shpronësuar dhe as për shumën që duhej të paguhej sipas VKM 206.

11. Në një datë të paspecifikuar në shkurt 2008 ekspertët përgatitën raportin e tij për një sipërfaqe ekzakte të pronës së kërkuarve që ishte përdorur për rrugën. Pas një kërkesë nga gjykata sipas përlogaritjeve mbi sipërfaqen e shpronësuar sipas VKM 206, ai paraqiti një dokument me “pyetje dhe përgjigje”, që plotësonte raportin e tij.

12. Në një datë të paspecifikuar, kërkuarët dhanë deklaratën e tyre përmblylëse përpara Gjykatës së Apelit Tiranë. Ata iu referuan VKM 206 për të theksuar mospërputhjen e pretenduar të autoriteteve, që kishin rënë dakord t’i kompensonin për një pjesë të pronës së tyre që kishte shërbyer për trotuarin e rrugës, por e kishin refuzuar kompensimin për ndërtimin e vet rrugës. Ata arritën në përfundimin se duhej të kompensoheshin në “vlerën e tregut” të tokës që ishte përdorur për ndërtimin e rrugës.

13. Më 9 prill 2009, Gjykata e Apelit Tiranë e rrëzoi vendimin e shkallës së parë (shih paragrafin 7 më sipër) dhe vendosi në favor të kërkuarve. Ajo urdhëroi Ministrinë t’i kompensonte për sipërfaqen e shpronësuar me çmimin 5,000 ALL për m².

14. Më 8 maj 2009, kërkuarët depozituan një ankesë në Gjykatën e Lartë, duke argumentuar se Gjykata e Apelit Tiranë nuk i ishte referuar çmimit të duhur për metër katror për pronën e tyre sipas përcaktimit të VKM 139.

15. Në një datë të paspecifikuar, Ministria paraqiti ankesën e saj në Gjykatën e Lartë.

16. Më 21 shkurt 2012, Gjykata e Lartë i rrëzoi të dy ankesat si të papranueshme me anë të një vendimi *de plano* ku nuk përfshiheshin arsye.

17. Më 21 mars 2014, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankesën kushtetuese të kërkuarit si haptazi të pabazuar. Ajo gjykoi se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë ishte mjaftueshëm i arsyetuar, dhe

sipas argumenteve të paraqitura pranë Gjykatës së Lartë, ajo gjykatë nuk kishte gabuar në rrëzimin e ankesave me anë të një vendimi *de plano*.

B. Ligji dhe praktika gjyqësore vendëse

18. Sipas nenit 459 të Kodit të Procedurës Civile (“KPC”) në fuqi përpara ndryshimeve të vitit 2017, një paditës konsiderohej të kishte hequr dorë nga pretendimet dhe argumentet që nuk ishin marrë në konsideratë në vendimin e shkallës së parë dhe nuk ishin ridorëzuar me anë të një anese në gjykatën e shkallës së dytë.

19. Në vendimin nr. 1283 të datës 22 tetor 1999, Gjykata e Lartë vlerësoi se argumenti i paraqitur përpara saj ishte paraqitur vetëm në terma të përgjithshëm përpara gjykatës së apelit. Sipas rrethanave, gjykata argumentoi se sipas interpretimit të nenit 459 të KPC-së, argumenti konkret nuk ishte shpjeguar në mënyrën e duhur përpara gjykatës së apelit; për këtë arsye Gjykata e Lartë nuk mund ta shqyrtonte.

20. Në shumë çështje të mëpasshme, Gjykata e Lartë iu referua nenit 459 të KPC-së për rrëzimin e shqyrtimit të pretendimeve dhe kërkesave që nuk ishin marrë në konsideratë në vendimin e shkallës së parë dhe nuk ishin riparaqitur në gjykatën e apelit (shih, për shembull, vendimi i kolegjeve të bashkuara nr. 10 i datës 15 nëntor 2011; vendimi nr. 366 i datës 30 shtator 2010).

VLERËSIMI I GJYKATËS

21. Kërkuarët u ankuan për një shkelje të së drejtës së tyre ndaj pronës sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, për shkak se Gjykata e Apelit Tiranë nuk i kishte akorduar kompensim për pronën e tyre të shpronësuar me çmimin prej 26,787 ALL për m², që ishte në fuqi në datën e atij vendimi gjykatë.

22. Parimet përkatëse për shterimin e mjeteve vendëse janë përmbledhur në *Vučković dhe të Tjerë kundër Serbisë* (kundërshtim paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §§ 69–77, 25 mars 2014.

23. Qeveria shpjegoi se kërkuarët nuk ishin ankuar për çmimin për metër katror përpara gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë. Sipas këndvështrimit të Qeverisë, kërkuarët e kishin ngritur atë çështje për herë të parë në ankesën e tyre në Gjykatën e Lartë, që nuk ishte rruga e duhur për të shteruar mjetet vendëse.

24. Gjykata nuk mund të mos merrte në konsideratë argumentin e Qeverisë për këtë aspekt. Ajo vëren se gjatë gjithë procedurave përpara



gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë, kërkesit ishin mbështetur ekskluzivisht në vlerësimin fillestar të pronës së tyre bërë nga autoritetet (shih paragrafin 5 më sipër). Gjithashtu, ata nuk kishin kërkuar caktimin e një eksperti për të bërë një vlerësim të ri për pronën e tyre në vlerën e tregut. Gjithashtu, ata nuk kishin kërkuar që eksperti i caktuar nga Gjykata e Apelit Tiranë të procedonte me një rivlerësim të tillë. Faktikisht, ata u mbështetën në raportin fillestar të ekspertit pa rezerva. Në mungesë të këtyre parashtrimeve gjatë fazës së provës së procedurave, referenca e kërkesve të deklarata përmbyllëse përpara Gjykatës së Apelit Tiranë për “vlerën e tregut” të pronës së tyre (shih paragrafin 12 më sipër), nuk ofronte baza të vlefshme për rishqyrtimin e kuantitetit të pretendimit të tyre për kompensim. Ai përfundim përforcohet me anë të faktit se edhe në deklaratën e tyre përmbyllëse, ata nuk sqaronin vlerën e tregut të pronës, ose mënyrën se si duhej të përllogaritej ajo pronë. Gjykata vlerëson se i takon kërkesve që të bëjnë shpjegime të detajuara për vlerën e supozuar të rritur të tokës së tyre, në varësi të periudhës përkatëse të shpronësimit, edhe në mungesë të një vendimi të Qeverisë për rregullimin e çështjes.

25. Në lidhje me VKM 139, Gjykata vëren se në periudhën midis 25 shkurtit 2008, kur ligji u botua dhe hyri në fuqi (shih paragrafin 9 më sipër), dhe 9 prillit 2009, kur Gjykata e Apelit Tiranë dorëzoi vendimin e saj, u takonte kërkesve të argumentonin se ai duhej të zbatohet për shpronësimin konkret, dhe ta paraqisnin ankesën e tyre sipas Konventës në Gjykatën e Apelit Tiranë. Megjithatë, nuk ka asnjë të dhënë se kërkesit iu referuan ndonjëherë VKM 139 gjatë gjykimit, ose në deklaratat e tyre përmbyllëse përpara asaj gjykate (shih paragrafin 12 më sipër). Në vend të kësaj, ata e ngritën këtë argument për herë të parë përpara Gjykatës së Lartë (shih paragrafin 14 më sipër).

26. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren, fillimisht, se sipas ligjit vendës, pretendimet që nuk ishin marrë në parasysh nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk ishin riparaqitur përpara gjykatës së apelit konsideroheshin sikur ishte hequr dorë prej tyre (shih paragrafët 18 deri 20 më sipër). Së dyti, kërkesit nuk shpjeguan në ankesën e tyre në Gjykatën e Lartë, apo në shpjegimet e tyre të mëpasshme, pse nuk kishin bërë shpjegime, në

lidhje me metodën e përllogaritjes përpara gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë.

27. Sipas rrethanave, ankesa e kërkesve në lidhje me pretendimin se gjykatat vendëse nuk kishin zbatuar VKM 139, mbetej i pashqyrtuar për meritat nga ato gjykata pasi ajo ankesë nuk ishte paraqitur në përputhje me rregullat vendëse (shih *Vučković*, cituar më sipër, § 72).

28. Së fundmi, shpjegimi i kërkesve përpara Gjykatës mund të konsiderohet më gjerësisht si një ankesë në lidhje me efektin e vonësës së autoriteteve për t'i paguar atyre kompensimin për pronën e tyre të shpronësuar. Në të vërtetë, Gjykata ka gjykuar se përshtatshmëria e kompensimit do të zvogëlohej nëse kompensimi do të paguhej pa iu referuar rrethanave të ndryshme përgjegjëse për zvogëlimin e vlerës së tij, të tilla si vonesat e paarsyeshme ose në mënyrë të pazakontë të gjata (shih *Frendo Randon dhe të Tjerë kundër Maltës*, nr. 2226/10, § 55, 22 nëntor 2011). Megjithatë, e drejta e kërkesve për të marrë kompensim të përshtatshëm, duke marrë në konsideratë periudhën kohore dhe rrethana të tjera, varej nga depozitimi i një pretendimi në gjykatë ku adresoheshin këto çështje në mënyrën e duhur me kërkesën për lehtësim. Për shembull, në parim kërkesit kishin mundësinë që të kërkonin një shumë më të lartë për metër katror (në varësi të vlerës në momentin e shpronësimit konkret), interes për shlyerje të vonuar, kompensim për çdo dëmtim ose humbje të fitimeve, apo të depozitonin ndonjë pretendim tjetër të ngjashëm. Megjithatë, Gjykata vëren se kërkesit nuk kanë kërkuar një lehtësim të tillë nga gjykatat vendëse.

29. Sipas këtij konteksti, Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme që të marrë një vendim për kundërshtimet e tjera të paraqitura nga Qeveria dhe arrin në përfundimin se ankesa e kërkesve në lidhje me shumën e kompensimit për pronën e tyre të shpronësuar duhet të rrëzohet sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshfrytëzim të mjeteve vendëse.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 19 janar 2023.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETAR

Georgios A. Serghides
KRYETAR



SHTOJCË

Kërkesa nr. 65774/14

Lista e kërkuësve

Nr.	Emri i kërkuësit	Viti i lindjes	Kombësia	Vendbanimi
1.	Dashuri LLAGAMI	1949		
2.	Suzana HAVERI (LLAGAMI) ndërruar jetë në vitin 2015 Trashëgimtarë: Miranda NOSI (LLAGAMI) Etleva BELIU (LLAGAMI) Bedar LLAGAMI	1927	Shqiptar/e	Tiranë
3.	Meleqe KODRA (LLAGAMI)	1931		
4.	Bardhyl LLAGAMI	1942		
5.	Dylbere LLAGAMI	1955		
6.	Fatri LLAGAMI ndërruar jetë në vitin 2014 Trashëgimtarë: Bedar LLAGAMI Etleva BELIU (LLAGAMI)	1933		
7.	Qemal LLAGAMI	1928		

GJYAKATA EVROPIANE E TË
DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË
VENDIM

Kërkesa nr. 45799/13
**DURIM SULKJA KUNDËR
SHQIPËRISË**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 5 dhjetor 2023 si Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *president*,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit*,

duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 45799/13) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) më 9 korrik 2013 nga shtetasi shqiptar z. Durim Sulkja (“kërkuesi”), i lindur në vitin 1950, që jeton në Elbasan dhe i përfaqësuar nga znj. S. Sulkja, avokate e licencuar në Elbasan;

vendimin për të njoftuar për kërkesën Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) të përfaqësuar fillimisht nga agentja e saj A. Hiçka dhe E. Muçaj, dhe më

pas nga agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

parashtrimet e palëve;

pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me mosekzekutimin e pretenduar të një vendimi në favor të kërkuësit.

A. Objekti i mosmarrëveshjes

Në vitin 1996, Autoriteti Kombëtar i Strehimit (“AKS”) në Elbasan autorizoi kërkuësin që të përdorë një apartament në pronësi të shtetit. Në vitin 1999, AKS vlerësoi apartamentin në vlerë 981.305 lekë.

2. Kërkuesi kishte për qëllim të përdorte të drejtën e tij të ligjshme për të blerë apartamentin, por nuk ra dakord me vlerësimin e AKS-së. Në një datë të paspecifikuar ai filloi procesin gjyqësor ndaj tyre.

3. Më 3 korrik 2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan (“Gjykata e Rrethit”) shfuqizoi vlerësimin e apartamentit nga AKS-ja dhe e urdhëroi të lidhë kontratë shitjeje me kërkuësin me çmimin 10,889 lekë të përcaktuar nga një ekspert i caktuar nga gjykata.

4. Më 23 tetor 2012, vendimi u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës.

5. Më 21 nëntor 2017, Gjykata e Lartë refuzoi ankimin e AKS-së për pyetje të ligjit.



6. Më 11 shkurt 2021, Gjykata Kushtetuese për mosshërim të mjeteve ligjore refuzoi ankimimin e kërkuarit që kohëzgjatja e procesit kishte qenë përtej afateve të arsyeshme.

B. Procedura e ekzekutimit

7. Pas vendimit të gjykatës së apelit, vendimi i 3 korrikut 2009 u bë i ekzekutueshëm sipas së drejtës së brendshme. Më 1 shkurt 2013, Gjykata e Rrethit nxori një urdhër ekzekutimi.

8. Më 5 mars dhe 22 maj 2013, AKS-ja thirri kërkuarin për nënshkrimin e kontratës së shitjes bazuar në kontratën tip që përdorte institucioni.

9. Me sa duket drafti i propozuar nga AKS-ja përfshinte një klauzolë sipas të cilës kërkuari nuk mund të shiste apartamentin për një periudhë 15-vjeçare. Gjithashtu, me sa duket kërkuari nuk ishte dakord me këtë klauzolë dhe disa kushte të tjera dhe prandaj ai refuzoi të nënshkruajë draftin.

10. Më 30 mars 2015, Gjykata Kushtetuese refuzoi ankimin e kërkuarit për mosekzekutimin e vendimit të 3 korrikut 2009. Gjykata vëren që AKS-ja ishte përgatitur për të lidhur një kontratë shitjeje me kërkuarin dhe që ky i fundit kishte kërkuar që në të të përfshihen afate të paarsyeshme. Gjykata konkludoi që situata ishte rezultat i refuzimit nga vetë kërkuari për të nënshkruar kontratën.

11. Ndërmjet periudhës 2014 dhe 2021, AKS-ja dhe kërkuari shkëmbyen shkresa, ku i pari u shpreh që draftkontrata ishte standarde e miratuar nga departamenti juridik i tij, ndërsa i dyti propozoi një tekst të ndryshëm.

VLERËSIMI I GJYKATËS

12. Kërkuari pretendoi shkelje të nenit 6 § 1 dhe 13 të Konventës si edhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1, në lidhje me mosekzekutimin nga autoritetet të vendimit të 3 korrikut 2009.

13. Gjykata përsërit që ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si një pjesë e pandarë e “seancës gjyqësore” për qëllime të nenit 6. Gjithashtu ajo i referohet praktikës gjyqësore në lidhje me mosekzekutimin ose ekzekutimin me vonesë të vendimeve të brendshme të formës së prerë (shihni *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, 40, *Raporte të Vendimeve* 1997 II).

14. Vendimi i 3 korrikut 2009 i Gjykatës së Rrethit përcaktoi vlerën e apartamentit. As kërkuari as dokumentet në dosjen e çështje nuk sugjerojnë

që autoritetet kërkuar një shumë të ndryshme nga kërkuari.

15. Mosmarrëveshja e pazgjidhur ndërmjet kërkuarit dhe AKS-së ka të bëjë me kushte të tjera të kontratës. Kërkuari parashtoi që nga vendimi i 3 korrikut 2009 të Gjykatës së Rrethit dilte në mënyrë të nënkuptuar që kushtet e tjera të kontratës duhej të ishin bazuar në modelin e përdorur të asaj kohe. Në mbështetje të argumentit të tij ai paraqiti disa kontrata të lidhura nga AKS-ja gjatë asaj periudhe dhe pretendoi se drafti që ai i kishte paraqitur AKS-së ishte në përputhje me ato. Qeveria kundërshtoi atë argument dhe u parashtoi që duhej të përdorej drafti i AKS-së.

16. Duke pasur parasysh dokumentet e paraqitura dhe argumentet e palëve, Gjykata nuk mund të konfirmojë pretendimin e kërkuarit që vendimi i 3 korrikut 2009 mbulonte në mënyrë të nënkuptuar kushte të tjera të shitjes përveç çmimit të apartamentit. As dispozitivi as teksti i atij vendimi nuk e mbështetin atë pretendim. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese (shihni paragrafin 10 më sipër) interpretoi situatën në të njëjtën mënyrë. Në mungesë të një treguesi në këtë drejtëm, nuk i takon Gjykatës që të vendosë si gjykatë e shkallës së parë për mosmarrëveshjen, në lidhje me kushtet e mbetura të shitjes ndërmjet kërkuarit dhe AKS-së.

17. Në këto rrethana, nisur nga fakti që autoritetet nuk kanë refuzuar të respektojnë vendimin e 3 korrikut 2009 të Gjykatës së Rrethit, Gjykata e gjen ankimin të pabazuar dhe të tillë që duhet të refuzohet sipas nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,
Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 18 janar 2024.

Olga Chernishova
ZËVENDËSKANCELARE

Georgios A. Serghides
PRESIDENT

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUTSEKSIONI I TRETË
VENDIMKërkesa nr. 34926/18
**GENTIANA HOXHA KUNDËR
SHQIPËRISË**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 13 dhjetor 2022, si një Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar*,

Jolien Schukking,

Darian Pavli, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretar i Seksionit*,
duke marrë në konsideratë:

kërkesën (nr. 34926/18) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 11 korrik 2018 nga një shtetase shqiptare, znj. Genita Hoxha, e cila ka lindur në vitin 1984 dhe banon në Tiranë (“kërkuesja”), e cila u përfaqësua nga z. G. Muçaj, një avokat që e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar në lidhje me ankesën Qeverinë Shqiptare (“Qeveria”), fillimisht e përfaqësuar nga ish-agjenti i saj, z. A. Metani, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

vërejtjet e palëve;

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Pas ndërprerjes së kontratës së saj të punësimit me Ambasadën e Kosovës në Tiranë, kërkuesja ngriti një padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë ndaj ish-punëdhënësit të saj, ku kundërshtonte shkarkimin e saj. Më 28 dhjetor 2016, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi kundërshtimin e palës së paditur që pretendonte se mosmarrëveshja ishte jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare.

2. Më 6 nëntor 2016, ndryshimet në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese hynë në fuqi, duke shkurtuar afatin për dorëzimin e një ankese kushtetuese nga dy vjet në katër muaj “pas vënies në dijeni për ndërhyrjen [me një të drejtë ose liri kushtetuese]”, dhe dispozita në lidhje me afatin e ri do të hynte në

fuqi më 1 mars 2017.

3. Si pala e paditur edhe kërkuesja depozituan ankese kundër vendimit më 28 dhjetor 2016 pranë Gjykatës së Lartë dhe procedurat pranë asaj gjykate nisën më 23 mars 2017. Gjykata e Lartë mbajti një seancë më 27 prill 2017, ku theksonte pjesën operative të vendimit të saj që rrëzonte vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe duke vendosur se mosmarrëveshja ishte jashtë juridiksionit të Gjykatave Shqiptare. Vendimi i Gjykatës së Lartë iu dorëzua kërkueses më 18 shtator 2017.

4. Sipas kërkueses, ajo depozitoi një ankesë kushtetuese më 23 janar 2018 dhe sipas Qeverisë më 24 janar 2018. Kërkuesja pretendonte se ishte shkelur e drejta e saj për t’iu drejtuar gjykatës dhe e drejta e saj për t’iu drejtuar një gjykate të paanshme, dhe se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ishte arsyetuar në mënyrën e duhur, dhe se nuk ishte respektuar parimi i sigurisë juridike. Më 8 shkurt 2018, Gjykata Kushtetuese e deklaroi ankesën e kërkueses të papranueshme pasi ishte depozituar jashtë afatit katërmujor, duke e përlllogaritur periudhën nga data 27 prill 2017, datë kur Gjykata e Lartë miratoi vendimin e saj.

VLERËSIMI I GJYKATËS

5. Kërkuesi u ankua se ajo nuk mund t’i drejtohej Gjykatës Kushtetuese sepse ajo e kishte përlllogaritur afatin katërmujor për depozitim të ankesës kushtetuese nga data e miratimit të vendimit të miratuar nga Gjykata e Lartë dhe jo nga data kur ky vendim i ishte dorëzuar asaj.

6. Gjykata vëren se kërkuesja depozitoi një ankesë kushtetuese ndaj vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë të miratuar më 27 prill 2017, që do të thotë pas datës 1 mars 2017 kur hyri në fuqi dispozita që parashikonte një afat katërmujor për depozitim të një ankese kushtetuese. Për këtë arsye, afati katërmujor zbatohet qartazi për çështjen e kërkueses.

7. Gjykata vëren se palët ranë dakord që vendimi i Gjykatës së Lartë iu dorëzua avokates së kërkueses më 18 shtator 2018, dhe se sipas kërkueses, ajo e dorëzoi ankesën e saj kushtetuese më 23 janar 2018. Në vijim, Gjykata vëren se edhe nëse e pranon pozicionin e kërkueses se afati katërmujor për depozitim të ankesës kushtetuese kishte filluar të përlllogaritej nga data kur asaj i ishte dorëzuar vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë, ai afat përfundonte më 18 janar 2018, që ishte e enjte dhe një ditë normale zyrtare në



Shqipëri. Megjithatë, kërkesja pretendonte se ajo e kishte depozituar ankesën e saj kushtetuese të martën në vijim, 23 janar 2018. Pra, në çdo rast ajo ishte dorëzuar jashtë afatit katërmujor.

8. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se ankesa e kërkeses për mungesën e mundësisë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese ishte haptazi e pabazuar, pasi i mungon çdo indici për shkeljen e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës të parashikuar në nenin 6 të Konventës (shih, për parime të përgjithshme, *Zubac kundër Kroacisë* [DHM], nr. 40160/12, §§ 76–99, 5 prill 2018).

9. Rezulton se kjo pjesë e kërkesës duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 § 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,
E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 26 janar 2023.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETAR

Georgios A. Serghides
KRYETAR

URDHËR

Nr. 71, datë 15.2.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN E MINISTRIT TË DREJTËSISË NR. 65, DATË 9.2.2024, “PËR DELEGIM KOMPETENCE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Në pikën 1, të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 65, datë 9.2.2024, “Për delegim kompetence”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga ora 12:00 e datës 12.2.2024 deri në datën 15.2.2024, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

URDHËR

Nr. 88, datë 13.2.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E GREQISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, të materialit biologjik dhe të nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-s dhe ADIS-së, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Aegean	North Aegean	Lesbos*
Thessaly and Central Greece	Central Greece	Lokroi*

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha

kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, të materialit biologjik dhe të nënprodukteve të



kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, nga ndarjet administrative të shtetit të Greqisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.3:

2.1 Për kafshët e llojit të dhirta dhe të leshta certifikata veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja, ose për 21 ditët e fundit, në një stabiliment ku nuk është raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve ose dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti nuk ka qenë i vendosur në një zonë të infektuar me linë e dhenve ose të dhive; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine për 21 ditë para dërgesës;

ç) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 4 muaj përpara dërgesës (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë, i çaktivizuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshirë në vaksinë duhet të shënohen në certifikatë).

2.2. Për spermën e cjepëve dhe deshëve, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se kafshët dhuruese:

a) nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e mbledhjes së spermës dhe për 21 ditët në vijim;

b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virus i gjallë i inaktivuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen gjithashtu në certifikatë).

2.3 Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se këto produkte:

a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga Autoriteti Veterinar i vendit eksportues.

3. Urdhri nr. 659, datë 10.11.2023, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Greqisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari



URDHËR

Nr. 89, datë 13.2.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE
DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E
BULLGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Burgas	Sredets*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjithë kafshëve gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, nga ndarjet administrative të shtetit të Bullgarisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.3:

2.1. Për kafshët e llojit të dhirta dhe të leshta certifikata veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja, ose për 21 ditët e fundit, në një stabiliment ku nuk është raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve ose dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti nuk ka qenë i vendosur në një zonë të infektuar me linë e dhenve ose të dhive; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine për 21 ditë para dërgesës;

ç) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 4 muaj përpara dërgesës (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë, i çaktivizuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshirë në vaksinë duhet të shënohen në certifikatë).

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE dhe ADIS, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

2.2. Për spermën e cjapeve dhe deshve, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se kafshët dhuruese:

a) nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e mbledhjes së spermës dhe për 21 ditët në vijim;

b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virus i gjallë i inaktivuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen gjithashtu në certifikatë).

2.3. Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se këto produkte:

a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose;

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga Autoriteti Veterinar i vendit eksportues.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar



të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 90, datë 13.2.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE
DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E
TURQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, të materialit biologjik dhe të nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-së, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Adana	Koçan*	

